



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
TIRANË



Nr. Regj. Them 3136/525
Datë. Regj. 13.05.2022
ICMIS 31138-02901-80-2022

Nr. vendimi 425(80-2023-456)
Datë vendimi 28.02.2023

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, e përbërë prej:

GJYQTARE : SELVIE GJOÇAJ

Asistuar nga sekretare gjyqësore Erjona Ukperaj, në Tiranë, sot më datë 28.02.2023 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen administrative nr. regj. them 3136/525, nr. ICMIS 31138-02901-80-2022, që i përket:

PADITËS:

Shoqata Humanitare e Invalidëve Paraplegjike dhe Tetraplegjike të Shqipërisë "SHIPT regjistruar si person juridik me vendimin nr. 294, date 24.06.2002 të Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NJPT 1613184515, përfaqësuar nga Drejtor Ekzekutiv Ndrek Ismajli, me adresë për efekt njoftimi nga gjykata: Blv. "Gjergj Fishta" Nd 24, H3 Ap 7 Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga Av. Irena Dule Anëtar e Dhomës së Avokatisë Tiranë me nr. Liç. 1969, Nipt K81328030G dhe Av. Dorian Matlija Anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, me nr. Liç 2621, Nipt K81328030G, caktuar me deklarim në seancë.

E PADITUR:

Bashkia Tiranë, përfaqësuar në gjykim përfaqësuar në gjykim nga znj. ipas autorizimit nr. 23640 prot, datë 27.06.2022 dim nr. 18089, datë 08.05.2018 "Për delegimin ndjekjen e disa procedurave mbi përfaqësimin ligjor '(në mungesë në seancën e shpalljes së vendimit).



RR445286777AA

k i Bashkisë Tiranë (në mungesë).

OBJEKTI:

- Detyrimin e të paditurit Bashkia Tirane të ndërtojë rrëthimin e kufijve të rinj të pronës nr. 99 "Repart Ushtarak nr. 5011/45, me vendndodhje në Surrel, Farke, Tirane dhe çdo element që lidhet me rrëthimin, duke i kthyer ato në gjendjen e mëparshme (te rehabilituar), sipas pikës 3 të VKM nr. 478, datë 17.06.2020.
- Detyrimin e të paditurit Bashkia Tiranë të kryeje spostimin e rrjeteve inxhinierike që prek gjurma e sipërfaqes se pronës (rrjet rrugor,

kanalizime uji të pijshëm dhe ujera të shkarkimit, lidhje me rrjetin e energjisë elektrike, etj.) sipas parametrave e kushtevc teknike që mundëson shfrytëzimin efektiv të pronës nga paditësi, sipas pikës 3 të VKM nr. 478, datë 17.06.2020.

3. Detyrimin e të paditurit Bashkia Tirane të krijoje të gjitha kushtet e përshtatshme për aksesueshmerine (duke ndërtuar rrugën lidhëse me rrugën kryesore automobilistike) dhe të eliminoje të gjitha pengesat infrastrukturore dhe mjedisore në pronën me emërtimin "Repart Ushtarak nr. 5011/45, me vendndodhje ne Surrel, Farke, Tirane, për personat paraplegjike dhe tetraplegjike (qe përdorin karrige me rrata).

4. Detyrimin e të paditurit Bashkia Tirane, t'i japë paditësit ne përdorim pa kundërshpërbirim, me huapërdorje, pronën nr. 99 Repart Ushtarak nr. 5011/45, me vendndodhje ne Surrel, Farke, Tirane, ne mënyrë të përshtatshme për të përm bushur qëllimin e zhvillimit të veprimtarisë së paditësit.

5. Dhënen e vendimit të gjykatës me ekzekutimi të përkohshëm.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës se Shqipërisë, neni 4; neni 18; neni, 59, Ligji nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatës administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", Ligji nr. 8626 date 22.06.2000 Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik ", Ligji nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar".

Në përfundim të hetimit gjyqësor të çështjes, të zhvilluar në prani të përfaqësuesit të paditësit, në mungesë të palës së paditur dhe personit të tretë, Gjykata, pasi e dëgjoi palën paditëse e cila përfundimisht kërkoi, pranimin e kërkese padisë sipas objektit, si dhe analizoi provat e paraqitura nga palët dhe bisedoi çështjen në terësi,

VËREN SE:

Paditësi Shoqata Humanitare "E Invalidëve Paraplegjike dhe Tetraplegjike të Shqipërisë" ka paraqitur përparrë Gjykatës një kërkcsë padi, me objekt: " 1. Detyrimin e të paditurit Bashkia Tiranë të ndërmarrë masa për rehabilitimin, aksesueshmerine dhe eliminimin e të gjitha pengesave infrastrukturore dhe mjedisore në pronën me emërtim "Reparti ushtarak nr. 5011/5" dhënë në përdorim paditësit SHIPT.2. Detyrimin e të paditurit Bashkia Tiranë, të krijojë një rruge kalimi dhe t'a bëje të aksesueshme pronën "Reparti ushtarak nr. 5011/5 dhënë në përdorim paditësit SHIPT. për t'u përdorur për personat që përdorin karrige me rrata.3. Detyrimin e të paditurit Bashkia Tiranë, të ndërllojë rrethimin në kufijë e pronës dhe çdo element që lidhet me rehabilitimin e rrethimit duke i kthyer në gjendjen e tyre të mëparshme.4. Detyrimin e të paditurit Bashkia Tiranë, të rehabilitoje dhe restauroje ambientet e brendshme të objekteve në pronën "Reparti ushtarak nr. 5011/5" me qëllim zhvillimin e veprimtarisë se paditësit. 5. Detyrimin e të paditurit Bashkia Tiranë që të njohe si date të fillimit të zbatimit të kontratës 10 vjeçare të huapërdorjes nr. 4389/2, datë 16.02.2021 lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurit, datën kur do të përbushen detyrimet nga i padituri Bashkia Tiranë për dorëzimin e objekteve të rehabilituara dhe sistemuara sipas objektit të kësaj padie".

Gjykata, bazuar në nenin 36 të Kodit të Procedurës Civile, konstatoi kryesisht se kjo çështje bën pjesë në juridikcionin gjyqësor dhe bazuar në nenet 7, 10/1 dhe 11/2 të ligjit nr.

49/ 2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është kompetente nga pikëpamja lëndore, funksionale dhe tokësore për shqyrtimin gjyqësor të saj.

Bazuar në parashikimet e nenit 12/1 të ligjit nr. 49/ 2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, çështja u mor në shqyrtim nga trup gjyques i përbëre nga një gjyqtar.

Bazuar në parashikimet e nenit 79/a të K.Pr.Civile, kërkese padia dhe aktet ju njoftuan dhe Avokaturës së Shtetit, e cila me shkresë deklaroi mospjesëmarrjen, duke ia deleguar të drejtën e përfaqësimit dhe mbrojtjes organit publik.

Gjatë veprimeve përgatitore, me kërkeshë të palës paditëse bazuar në nenin 192 të K.Pr.Civile u thirr në gjykim në cilësinë e personit të tretë Këshilli Bashkiak i Bashkisë Tiranë.

Po kështu, gjatë verimeve përgatitore, me kërkeshë të palës paditësc, bazuar në nenin 161/c të K.Pr.Civile, u thirr në gjykim në cilësinë e palës së paditur Ministria e Mbrojtjes. Në vijim të veprimeve, pala paditëse hoqi dorë nga kjo kërkese, e ne këto kushte, gjykata, bazuar në nenin 39 të ligjit 49/ 2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar vendosi pushimin e për palën e paditur Ministria e Mbrojtjes.

Gjithashtu, me kërkeshë të palës paditëse, bazuar në nenin 185 të K.Pr.Civile u saktësua objekti i padisë, duke këruar: "*1. Detyrimin e të paditurit Bashkia Tirane të ndërtojë rrëthimin e kuqijve të rinj të pronës nr. 99 "Repart Ushtarak nr. 5011/45, me vendndodhje në Surrel, Farke, Tirane, dhe çdo element që lidhet me rrëthimin, duke i kthyer ato në gjendjen e mëparshme (te rehabilituar), sipas pikës 3 të VKM nr. 478, datë 17.06.2020.2. Detyrimin e të paditurit Bashkia Tirane të kryeje spositimin e rrjeteve inxhinierike që prek gjurma e sipërsaqes se pronës (rrjet rrugor, kanalizime uji të pijshëm dhe ujera të shkarkimit, lidhje me rrjetin e energjisë elektrike, etj.) sipas parametrave e kushteve teknike që mundëson shfrytëzimin efektiv të pronës nga paditësi, sipas pikës 3 të VKM nr. 478, datë 17.06.2020.3. Detyrimin e të paditurit Bashkia Tirane të krijoje të gjitha kushtet e përshtatshme për aksesueshmërinë (duke ndërtuar rrugën lidhëse me rrugën kryesore automobilistike) dhe të eliminoje të gjitha pengesat infrastrukturore dhe njëdisore në pronën me emërtimin "Repart Ushtarak nr. 5011/45, me vendndodhje ne Surrel, Farke, Tirane, për personal paraplegjike dhe tetraplegjike (qe përdorin karrige me rrota).4. Detyrimin e të paditurit Bashkia Tirane, t'i japë paditësit ne përdorim pa kundërshtpërbllim, me huapërdorje, pronën nr. 99 Repart Ushtarak nr. 5011/45, me vendndodhje ne Surrel, Farke, Tirane, ne mënyrë të përshtatshme për të përmbrushur qëllimin e zhvillimit të veprimtarisë së paditesit.5. Dhënen e vendimit të gjykatës me ekzekutim të përkohshëm*".

Më pas hetimi gjyqësor vijoi dhe u mbyll mes palëve, sipas objektit dhic bazës ligjore cituar në pjesën hyrëse të këtij vendimi

Nga hetimi gjyqësor rezultoi se:

Paditësi shoqata "E Invalidëve Paraplegjike dhe Tetraplegjike të Shqipërisë" është organizate joftimprurëse e regjistruar me vendinin nr. 294, date 24.06.2002 të Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe ka për qëllim qëllimi dhe objekt të veprimtarisë së saj: "*Sigurimin e një statusi të përshtatshëm të invalidit që ti përgjigjet gjendjes se rende dhe*

problematikës që kane invalidët paralegjike dhe tetraplegjike si dhe nivelit ekonomik që do të ketë shoqëria ne etapa të caktuara, sigurim të një shërbimi nijekësor të përshtatshëm profilaktik dhe rehabilitues ne klinika të veçanta si dhe klinikat e specializuara ekzistuese, sigurimin e një trajtimi qytetare me prioritet dhe lehtësimet e mundshme që u duhen bere kësaj kategorie invalidësh ne fushat shkollim, punësim, strehim, lëvizje urbane e interurbane, Hixha, mjete lëvizëse për shtëpi e jashtë saj, mjete komunikimi etj. “, fakt i provuar nga të dhënat e dokumentacionit të paraqitur si provë në gjykim konkretisht akt themelimi, statut, vendim regjistrimi si dhe vërtetimi, datë 01.07.2023, lëshuar nga Zyra e Regjistrit të OJF-ve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me vendimin Nr. 478 datë 17.6.2020 “*Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Tiranë, të një sipërsaqeje trualli funksional dhe të disa objekteve, brenda territorit të pronës nr.99, me emërtim “ish-Reparti Ushtarak nr.5011/45”, me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “për miratimin e listës se inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar*” Këshilli i Ministrave ka vendosur: ”1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Tiranë, të një sipërsaqeje trualli funksional dhe të disa objekteve, me sipërsaqe të përgjithshme prej 3 300 (tre mijë e treqind) m², nga trualli funksional i pronës nr.99, me emërtim “Ish-reparti ushtarak nr.5011/45”, vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

B) Hiqen trualli funksional dhe objektet, sipas planrilevimit, me sipërsaqe të përgjithshme prej 3 300 (tre mijë e treqind) m², nga trualli funksional i pronës nr.99, me emërtim “Ish-reparti ushtarak nr.5011/45”, me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë.

b) Përmasat e pronës nr.99, me emërtim “Ish-reparti ushtarak nr.5011/45”, me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin standard të inventarizimit dhe në planrilevimin që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

3. Për sigurinë dhe ruajtjen e pronës, para fillimit të punimeve, Bashkia Tiranë të ndërtojë rrëthimin në kufijtë e rinj të pronës dhe çdo element që lidhet me rrëthimin, duke i kthyer në gjendjen e tyre të mëparshme, të kryejë spostimin e rrjeteve inxhinierike që prek gjurma e sipërsaqes së pronës e cila i kalon në pronësi, sipas parametrave e kushteve teknike dhe për këtë të hartohet aktmarëveshje, ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Mbrojtjes, të përfaqësuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Komanda Mbështetëse.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

Për zbatimin e këtij vendimi, Ministri i Mbrojtjes ka nxjerë urdhrit nr. 811, datë 13.07.2020 “*Për zbatimin e vendimit Nr. 478 datë 17.6.2020 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Tiranë, të një sipërsaqeje trualli funksional dhe të disa objekteve, brenda territorit të pronës nr.99, me emërtim “ish-Reparti Ushtarak nr.5011/45”, me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “për miratimin e listës se inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar*” në bazë të të cilit janë përcaktuari masat konkrete strukturat përkatëse për zbatimin e tij.

Në vijim, mes Komandës Mbështetëse (Repartit Ushtarak nr. 4001) dhe Bashkisë Tiranë është lidhur dhe një akt marrëveshje bashkëpunimi nr. 5761 prot, datë 26.10.2020, e cila kishte për objekt : “*1.1 Dorëzimi dhe marrja në dorëzim e një sipërsaqeje truall funksional dhe disa objekteve me sipërsaqe të përgjithshme 3 300 (Tremijë e treqind) m², nga truall i përgjithshëm funksional i pronës me nr. 99, me emërtimin “Ish Reparti Ushtarak nr. 5011/45”, me vendndodhje ne Surrel Farke, Tirane, nga Komanda Mbështetëse të Bashkia Tiranë.*

1. 2. Ndërtimi i rrethimit të plotë të pronës dhe çdo element që lidhet me rrethimin dhe spostimin e njeteve inxhinierike që prek gjurma e sipërsfqes se pronës, e cila kalon në pronësi të Bashkisë Tiranë, sipas parametrave e kushteve teknike, duke kthyer në gjendjen e tyre të mëparshme.”.

Në vijim, në bazë të akt dorëzimit nr. 5808 regj. 28.10.2020 “Për dorëzimin nga Reparti Ushtarak nr.4001 dhe martjen në dorëzim dhe kalim në pronësi nga Bashkia Tirane, të një sipërsaqeje trualli funksional dhe të disa objekteve, brenda territorit të pronës nr.99, me emërtimin “Ish Reparti Ushtarak nr. 5011/45”, me vendndodhje në Surrel, Farke, Tiranë” grupet e punës të ngritur me urdhër të Komandantit të Repartit ushtarak 4001 (Komanda Mbështetëse) dhe Kryetarit të Bashkisë është bërë dorëzimi nga Repartit Ushtarak 4001 (Komanda Mbështetëse) Tiranë dhe marrja në dorëzim dhe kalimi në pronësi tek Bashkia Tiranë, i një sipërsaqeje nga trualli funksional dhe disa objekte, të pronës nr. 99, me emërtimin “Ish reparti ushtarak nr. 5011/45”, me sipërsaqe të përgjithshme sipas plan rilevimit të hartuar nga IGJIU 3300 (tremijë e treqind) m², nga e cila 466. 2 m² sipërsaqe nën objekt, përkalësish objekti nr. 3=303.9 m², objekti nr. 4=133,7 m² dhe objekti nr. 12=28.6 m².

Me Vendimin nr. 176, datë 21.12.2020 “Për miratimin e dhënies ne përdorim pa kundershpërbllim, të pronës nr. 99, me emërimin Reparti Ushtarak nr. 5011/45”, me vendndodhje në Surrel, farkë, tiranë, Shoqatës së Invalidëve Para&Tetraplegjikë” Këshilli Bashkiak i Bashkisë Tiranë ka vendosur: “*1. Të miratojë dhënien në përdorim, pa kundershpërbllim për një periudhë 10-vjeçare, të pronës me nr. 99, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 5011/45”, me sipërsaqe trualli Str. 3300m² dhe sipërsaqe ndërtimi Shd. 466,2 m², me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë (sipas hartës treguese të Regjistrimit), Shoqatës se Invalidëve Para & Tetraplegjike të Shqipërisë 2. Ndalohet dhënia në përdorim të tretëve dhe ndryshimi i destinacionit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.*

3. Ngarkohet kryetari i Bashkisë apo personi i autorizuar prej tij për nënshkrimin e kontratës se huapërdorjes midis Bashkisë Tiranë dhe Shoqatës së Invalidëve Para & Tetraplegjike.

4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit përzbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 39/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar”.

Në vijim, me mes Bashkisë Tiranë në cilësinë e Huadhënësit dhe Shoqatës së Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë, në cilësinë e huamarrësit, është lidhur kontrata e huapërdorjes nr. 4389/1 prot, datë 16.02.2021, ku ne nenin 1 të saj, palët kanë përcaktuar objektin e konkretisht: “*Objekti i kësaj kontrate është dhënia në përdorim nga huadhënësi e truallit, me sipërsaqe 3300 m, ne Tirane, Lanabregas, pa kundershpërbllim për nevoja të huamarrësit*”, : ndërsa në nenin 2 qëllimin e saj, e konkretisht: ”*Qëllimi i kësaj kontrate është vënia në dispozicion nga Bashkia Tiranë e truallit me sipërsaqe 3300 m Tirane, Lanabregas, për zhvillimin e veprimtarisë se “Shoqatës se Invalidëve Para dhe Tetraplegjike”.*

Po këshnu, ndërmjet palës paditëse Shoqatës së Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë dhe palës së paditur Bashkia Tiranë është lidhur një martëveshje bashkëpunimi ne. 12408/1 prot, datë 23.03.2021, e cila sipas parashikimeve të nenit 1 të saj ajo kishte për objekt: "Përcaktimi i mënyrave të bashkëpunimit mes palëve për ofrim të shërbimeve cilësore ndaj qytetarëve që i përkasin grupeve në nevojë. Gjithashtu të përcaktoje mënyrat e bashkëpunimit të efektshëm mes palëve në rastet e adresimit të problematikave për ofrimin e shërbimeve me fokus të veçantë për integrimin e personave me aftësi të kufizuar në komunitet, rrjje të gjithëpërfshirës së personave me aftësi të kufizuar, si edhe aksesueshmërinë e tyre në shërbimet komunitare me qëllim riintegrimin e tyre".

Pala paditëse, i është drejtuar me kërkesa të vazhdueshme me shkrim palës së paditur ku i ka kërkuar që, bazuar parashikimet ligjore që përcaktojnë statusin e invalidëve para dhe tetraplegjikë të Shqipërisë, përfshirjen dhe aksesueshmerine e tyre, akteve dhe vepime juridike sipërcituar, të përmbushe detyrimet për rehabilitimin e rrëthimit, spostimin e rrjeteve inxhinierike, rehabilitimin e pronës së dhënë në huapërdorje dhe bërtjen e saj të aksesueshme nga persona me aftësi të kufizuar që përdorin karrige me trojë. Duke pretenduar se pavarësisht korrespondencës shkresore dhe takimeve që janë zhvilluar që prej miratimit të VKB nr. 176, date 21.12.2020, nënshkrimit të kontratës së huapërdorjes dhe marrëveshjes se bashkëpunimit, pala e paditur nuk ka marrë masat e nevojshme për përbushjen e detyrimeve, duke bërë që shoqata të mos mund të marrë në dorëzim efektivisht pronën (truallin dhe objektet) dhe ta përdorë atë në funksion të ushtrimit të veprimitarisë së saj. Në këto kushte, pala paditëse i është drejtuar gjykates me padinë objekt gjykim.

Gjatë gjykimit pala paditëse parashtroi këto pretendime:

- Pala e paditur, Bashkia Tirane ka dështuar në marrjen e masave për ndërtimin e rrëthimit të kufijve të rinj të pronës dhe çdo element që lidhet me rrëthimin, duke i kthyer ato në gjendjen e mëparshme, si dhe për spostimin e rrjeteve inxhinierike

Referuar fakteve të mësipërmre, me VKM-në nr. 478 datë 17.06.2020 prona shtetërore më emërtim "Ish Reparti Ushtarak nr. 501 1/45" me vendndodhje në Sutel, Farkë, Tiranë ka kaluar në pronësi të paditurit, Bashkia Tirane me qëllimin e veçantë dhënien me pas të saj në përdorim Shoqatës së Invalidëve Para & Tetraplegjikë të Shqipërisë. Me VKB-në nr. 176 date 21.12.2020 është miratuar dhënia në përdorim pa kundërshpërbirim të saj paditësit për një periudhë 10 vjeçare.

Në pikën 3 të VKM nr. 478, datë 17.06.2020 parashikohet: 3. Për sigurinë dhe ruajtjen e pronës, para fillimit të punimeve, Bashkia Tiranë të ndërtojë rrëthimin në kufijtë e rinj të pronës dhe çdo element që lidhet me rrëthimin, duke i kthyer në gjendjen e tyre të mëparshme të kryeje spostimin e rrjeteve inxhinierike që præk gjurma e sipërsfaqes se pronës, e cila i kalon në pronësi, sipas parametrave e kushteve teknike dhe për këtë të hartoher aktuarëveshje ndërmjet Bashkisë Tirane dhe Ministrisë se Mbrojtjes, të përfaqësuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Komanda Mbështetëse.

Përbushja e këtij detyrimi është kërkuar nga pala paditëse pëmtes shkresave që janë administruar si provë në dosje. Në përgjigje të këtij kërkimi, pala e paditur ka mbajtur qëndrimin që shpeuazimet për këtë zë do të planifikohen në buxhetin afatmesëm 2023-2024. Ndërkohë që vendimmarrja e Këshillit të Ministrave dhe e Këshillit Bashkiak të Tiranës daton që në vitin 2020. Siç rezultoi në seancë gjyqësore, planifikimi i buxhetit lidhet vetëm me rrëthimin e pronës, por jo me spostimin e rrjeteve inxhinierike (rrjet rrugor, kanalizime uji të pijshëm dhe ujëra të shkarkimit, lidhje me rrjetin e energjisë elektrike, etj.). Referuar të përfaqësuar nga pala paditëse i është kërkuar që përfundimisht të përfshijet gjykata administrative, që do të bëhet përmes një dështimit të përfunduar.

gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", kërkesa e palës paditëse në pikat 1 dhe 2 të objektit të padisë, është e drejtë, e mbështetur në ligj e në prova.

-Pala e paditur, Bashkia Tiranë ka dështuar se krijuari të kushteve të përshtatshme për aksesueshmérinë për personat paraplegjike dhe tetraplegjike.

Ligji nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmérinë e personave me aftësi të kufizuar" parashikon se personave me aftësi të kufizuar duhet t'i garantohet;

a) aksesueshmëria nëpërmjet mënjanimit të pengesave infrastrukturore të cilat përfshijnë ato

ne banesa, hapësira dhe shërbime publike, pengesa mjedisore, institucionale si dhe sociale;

b. përfshirja, nëpërmjet se cilës mundësohet pjesëmarrja e duhur dhe e barabarte e personave me aftësi të kufizuara ne të gjitha sferat e jetës.

Gjithashtu neni 2 i këtij ligji ndër të tjera synon të përcaktojë:

b. Përgjegjësinë e strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe organet vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmerise për të zvogëluar deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuar me qollim mundësimin e pjesëmarrjes se tyre të barabarte ne shoqëri".

Prona që është destinuar për tu dhënë në përdorim pa kundërshtperblim palës paditëse, jo vetëm që përbush kriteret për tu konsideruar lidhur me detyrimet e Bashkisë Tiranë për aksesueshmërinë, por, për më tepër, do të përdoret pikërisht nga persona me aftësi të kufizuar. Prona është e paksesueshme aktualisht sepse i mungon rruga lidhëse mes rrugës kryesore dhe vetë pronës, ka shumë shkallë në një terren të thyer, si dhe vetë terreni është i ngarkuar me gurë e shkëmbinj që e bën të pamundur manovrimin me karrige me rrata. Pala e paditur, Bashkia Tiranë, nuk e kundërshtoi këtë fakt gjatë gjykimit.

Referuar parashikimit të nenit 17/1 gjermane "ç" të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", konkludojmë se i padituri Bashkia Tiranë, nuk ka përbushur detyrimet ligjore, duke cenuar të drejta të ligjshme të komunitetit të personave paraplegjike dhc tetraplegjike, si dhe vetë organizatës paditëse, pasi kjo e fundit ka marrë përsipër të kryejë aktivitete që lidhen me dhënien e shërbimeve këtij komuniteti, sipas marrëveshjes së lidhur më 23.03.2021 mes palëve ndërgjyqëse.

-Pala e paditur, Bashkia Tiranë nuk ka përbushur detyrimin për të dhënë në përdorim pa kundërshtperblim, me huapërdorje, pronën në mënyrë të përshtatshme për të përbushur qëllimin e zhvillimit të veprimitarisë së paditësit. Midis palëve ndërgjyqëse, më 23.03.2021 është lidhur një marrëveshje bashkëpunimi, e cila nō nenin 3 të saj përcakton se: "Kjo marrëveshye bashkëpunimi ka si për qëllim të përcaktojë angazhimet kryesore të bashkëpunimit midis palëve, në ugritjen e kapaciteteve të aktorëve vendore dhe mbështetje, bashkëpunim mes palëve. Gjithashtu rritje të gjithëpërfshirjes së personave me aftësi të kufizuar, si edhe aksesueshmerine e tyre ne shërbimet komunitare me qellim riorganizimin e tyre".

Gjithashtu, nō nenin 4 të kësaj marrëveshjeje parashikohen rolet dhe përgjegjësitë e palëve ku ndër të tjera përcaktohet se: "Bashkia Tiranë merr përsipër:

- Dhënien ne përdorim pa kundershtperblim për një periudhe 10 vjeçare, të pronës me nr. 99, me emërtimin Reparti Ushtarak nr.5011-45", me sip trualli Str-3300 dhe sip. ndërtimi Sh 466.2m, me vendndodhje ne Surrel, Fushë, Tiranë (sipas hartës treguese të Regjistrimit), Shoqatës se Invalidëve Para& Tetraplegjike të Shqipërisë, miratuar me VKB nr. 176 date 21.12.202...
- Të bashkëpunojë me SHIPT e menaxhimin e çështjeve aktuale të personave me aftësi të kufizuar
- Te koordinojë me SHIPT ofrimin e shërbimeve të integruese për personat me aftësi të kufizuar.
- Të bashkëpunojë me SHIPT ne ofrim të shërbimeve të reja me fokus personat me aftësi e kufizuar ne kuadër të kësaj marrëveshjeje."

Në ketë marrëveshje, Bashkia Tiranë ka shfaqur gatishmërinë për të bashkëpunuar dhe ndihmuar paditësin në ushtimin e veprimitarisë së tij. Kjo ndihmë lidhur me menaxhimin e çështjeve aktuale dhe ofrimit e shërbimeve të integruara, nuk mund të kuptohet pa dhënien në përdorim të pronës në kushtet minimale të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar, një detyrim i cili nuk është përimbushur.

Qëllimi i VKM nr. 478, datë 17.06.2020 dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës, nr. 176, date 21.12.2020 është pikërisht dhënia në përdorim e kësaj prona. Ky detyrim është materializim i detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 8626, date 22.06.2000 "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", i cili në nenin 14 parashikon: "Shteti merr përsipër të vere ne dispozicion dhe të japë falas mjedise për zhvillimin e veprimitarisë së shoqatës të invalidëve paraplegjike dhe tetraplegjike"

Gjate gjykitimit u provua që pala e paditur nuk ka bërë asnjë veprim për të dhënë pronën në përdorim. Në lidhje me këtë:

Se pari, vlen të theksohet se kontrata e huapërdorjes së lidhur mes palëve nuk është për godinat por vetëm për truallin. Prona përmban edhe godina, të cilat duhet të shërbenin pikërisht për të zhvilluar veprimitarinë e saj organizata paditësse.

Se dyti, godinat janë nç një gjendje të mjerueshme dhe tëresisht të papërdorshme. Bashkia Tiranë, nga njëra anë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me paditësin për kryerjen e një serie gjatë shërbimesh dhe, nga ana tjeter, nuk ka mundësuar dhënien në përdorim të ambienteve, si detyrim nga ligji, akti nënligjor i posaçëm, vendimi i Këshillit Bashkiak dhe vete marrëveshjes se lidhur me paditësin.

Se treti, dhe qëllimi i organit epror të pushtetit ekzekutiv (Këshilli i Ministrave, duket qarte që prona, jo vetëm duhet të jepet se përdorim, por edhe do të duhet të bëhen punime ne te. Pika 3 e VKM nr. 478, date 17.06.2020 parashikon: "Për sigurinë ruajtjen e pronës para fillimit të planimeve Bashkia Tiranë.."

Pala e paditur, Bashkia Tiranë, gjate gjykitimit nuk paraqiti kundërshti në lidhje me këtë pike. Për me tepër, ne një kronike të posaçme të përgatitur nga media Fax Neës me 11 Shkurt 2022, vihet re se ambientet janë të paksesueshem dhe tëresisht të amortizuar Kronika gjendet, në linkun : [Https://www.youtube.com/watch?v=rYYFdIYPmik](https://www.youtube.com/watch?v=rYYFdIYPmik).

Për këto arsy, kërkimi i katërt i objektit të padisë është i mbështetur në ligj dhe në prova dhe paditësi me se drejte i është drejtuar gjykatesh në baze të nenit 17, pika 1, gjermana "e" të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar Paditësi vërtetohet që ka një interes të lligjshëm, i cili mund të përbushet vet nëse pranohet edhe kjo pike e kërkesë padis, dhe prona jepet në përdorim, në mënyrë të përshtatshme për të realizuar qëllimin.

Dhënia e vendimit me ekzekutim të përkohshëm:

Paditësi kërkon nga Gjykata që vendimi, ne rastin eventual të pranimit të padisë, të jepet me ekzekutim të përkohshëm në referim të nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile për vetë natyrën e tij, duke qenë se ekzekutimi i përkohshëm i këtij vendimi do të ndihmone të sigurimin e ambienteve të domosdoshme për paditësin. Një arsy kryesore shtesë që e bën këtë rast të konsiderohet se duhet aplikuar kjo dispozite është edhe fakti që paditësi do të ofrojë shërbime me interes publik, duke i shërbyer komunitetit le personave me aftësi të kufizuar paraplegjike dhe tetraplegjike, të cilët vetëm në Tiranë janë afro 1.500 individë.

Është tashmë fakt që njihet botërisht se gjykimi në Gjykaten e Apelit do të marrë më shumë se 5 vjet të tjera pritje, në kushtet kur gjykata kanë staf të reduktuar për shkak të efekteve të reformës në drejtësi. Në rastin eventual që gjykata do të pranojë padinë, mbajmë parasysh edhe faktin që Bashkia Tiranë nuk pati kundërshtime konkrete me objektin e padisë, por u shpreh në përgjithësi se kërkon rrëzimin sepse ka nisur planifikimin e buxhetit. Një vendime me ekzekutim të përkohshëm do të nxiste Bashkinë Tiranë që të vijojë me procedurat e planifikimit të buxhetit më shpejt, për sa kohë nuk ka kundërshtime konkrete.

Bazuar në këto argumente, pala paditëse kërkoi pranimin e kërkese padisë sipas objektit.

Gjatë gjykimit pala e paditur parashtroi këto prapësimë:

Së pari, Bashkia e Tiranës ka patur dhe vazhdon të ketë bashkëpunim me Shoqatën e Invalidëve Para & Tetraplegjike, e cila është një organizatë jo qeveritare e themeluar në vitin 1992, dhe përfaqëson dhe përkrah individët para-tetraplegjike duke avokuar, lobuar dhe ofruar shërbime përmes rrjetit të shtrirë në të gjithë Shqipërinë, me qëllim arritjen e së drejtës për një jetesë të pavarur dhe me dinjitet të anëtarëve të saj.

Ne ligjin nr. 8626, datë 22.06.2000, për "Statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, (i ndryshuar), neni 14, citohet se "Shteti merr përsipër të vëré në dispozicion dhe të jepë falas mqedise për zhvillimin e veprimitarisë së shoqatës së invalidëve paraplegjike dhe tetraplegjike". Në vijim të korrespondencës shkresore të Bashkisë së Tiranës, Ministrisë si edhe Shoqatës pas shqyrtimit të kësaj kërkese dhe vlerësimit të projektit të propozuar, i cili merret në konsideratë për efektshmërisë së tij lidhur me shërbimin specifik që do të sigurojë për PAK, Bashkia e Tiranës pasi bëri të mundur verifikimin e të gjithë ambienteve në administrim të saj, mbi përbushjen e disa kritereve të posaçme lidhur me këtë qëllim është dakordësuar dhe finalizuar me Vendimin nr. 176 datë 21.12.2020, të Këshillit Bashkiak për "Miratimin e dhënieve në përdorim të ambientit të pronës nr.99, me emërtim Ish Reparti Ushtarak nr. 5011/45, vendndodhje Surtel, Farke, Tiranë, Shoqatës së Invalidëve Para & Tetraplegjikë të Shqipërisë". Theksojmë se ky vendim është realizuar me dakordësi të plotë dhe ka iniciuar me kërkeshë të shoqatës.

Me zbardhjen e vendimit sipërcituar është realizuar Kontrata e Hua Përdorjes nr. 4389/1, datë 16.02.2021 duke i dhënë mundësinë e përdorimit pa kundërshtpërbllim për një afat 10 vjeçar Shoqatës si edhe nga ana e Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale është realizuar Marrëveshja e Bashkëpunimit nr. 12408/1 prot e datës 23.03.2021 me të drejtë rinovimi me qëllim mundësinë e bashkëpunimeve në ofrimin e shërbimeve sociale për kategorinë të cilën kjo shoqatë përfaqëson.

Se dyti, në lidhje me mundësimin e rrethimit të pronës dhe çdo element që lidhet me të kjo shoqatë është vene në dijeni nëpërmjet shkresës nr. Sh-3108/4, date 10.05.2022 nga Drejtoritë përkatëse të Bashkisë se projekti i kërkuar është bërë pjesë në programin buxhetor 2022- 2024.

Bashkia e Tiranës ka në priorititetet të punës së saj përmirësimin dhe rrjetjen e mirëqenies sociale për të gjitha kategoritë sociale përmes zbatimit të programeve të përkujdesit social dhe ngritisë së kapaciteteve shërbimofruese ne të gjithë qytetin e Tiranës. Zgjerimi hartës se ofrimit të shërbimeve sociale si dhe mbulimi me shërbimine të perkujdesit shoqëror ndaj të gjitha kategorive sociale është dhe një ndër objektivat kryesore të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social.

Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale, ka mbështetur me priorititetet dhe programin e nxijes së politikave të reja lokale të Bashkisë së Tiranës, i cili synon të ofroje modele sociale alternative, me qëllim përmirësimin e cilësisë se jetës dhe integrimin e grupeve në nevojë në jetën sociale.

Bazuar në këto argumente, pala e paditur kërkoi rrëzinin e kërkesc padisë, si e pabazuar në ligj dhe në prova.

Personi i tretë Këshilli Bashkiak i Bashkisë Tiranë e la gjykimin e në mungese dhe nuk paraqiti prapësimë dhe prova.

Gjykata duke pasur parasysh pretendimet, prapësimet e palëve, provat e paraqitura prej tyre, si dhe parashikimet ligjore, qëmon se kërkimet e paditësit janë të bazuara. Në vijim po parashtrojmë argumentet:

Së pari, gjykata merr në analizë legitimimin e palëve në gjykim.

Neni 15/1/d i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar "E drejta e padisë" parashikon: "Të drejtën e ngritisë së padisë e ka: d) çdo shoqatë apo grup interes i që pretendon se është cenuar një interes i ligjshëm publik; i) nga një akt normativ; ii) nga një akt administrativ, në rast se një e drejtë e tillë u njihet me ligj".

Neni 17/1 i i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar "Objekti i padisë" parashikon: "I. Padia ngrihet: ç) për të detyruar organin publik të kryejë një veprim administrativ, që është refuzuar, apo për të cilin organi publik ka heshtur, ndonëse ka pasur kërkesë".

Neni 31 i K.Pr.Civile parashikon: "Padia është e drejta e personit që bën pretendimin, për t'u dëgjuar, mbi themelin e këtij pretendimi, në mënyrë që gjykata ta shpalë atë të bazuar ose jo. Pala kundërshtare ka të drejtë të diskutojë dhe të ngrejë prapësimë mbi themelin dhe bazueshmérinë në ligj të këtij pretendimi".

Neni 32 i K.Pr.Civile parashikon: "Padia mund të ngrihet: a) për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesit të ligjshëm që është shkelur; b) për vërtetimin e qenies ose mosqenies së një marrëdhënieje juridike ose një të drejte; c) për njohjen e vërtetësisë ose pavërtetësisë së një dokumenti me pasoja juridike për paditësin".

Në vendimin unifikues nr.05 datë 30.10.2012 Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arsyetojnë: "Interesi për të ngritur padi është një interes procedural, dylësor dhe instrumental në lidhje me interesin material dhe ka për objekt masën ose llojin e vendimit që i kërkohet gjykatesi si mjet për arritjen e përbushjes së interesit material i cili është cenuar apo shkelur nga sjellja e palës tjetër ose nga gjendja faktike objektive ekzistuese. Pra, interesit për të ngritur padi lind nga domosdoshmëria për të mbrojtur interesin material dhe për këtë arsy, në esencë, presupozon njohjen e cennit të një interesit që mund të përbushet duke kërkuar mbrojtjen në gjykatë. Interesi për të ngritur padi rezulton nga marrëdhënia midis situatës së kundra ligjshme që pretendohet dhe vendimit gjyqësor që kërkohet të merret për të rregulluar këtë situatë nëpërmjet zbatimit të së drejtës në fuqi, marrëdhënie që domosdoshmërisht duhet të konsistojë në dobishmérinë e vendimit që kërkohet të merret. Mungesa e një interesit do të thotë se, nëse ushtrimi i padisë nuk i siguron paditësit asnjë avantazh, gjykata duhet ta deklarojë atë si të papranueshme. Dhe po kështu, nëse mungon apo paditësi nuk arrin të provojë faktin cenes të së drejtës së tij padia është e papranueshme. Paditësi është i detyruar të provojë ekzistencën e disa kushteve ligjore para gjykates, kushte të cilat lidhen me vetë ekzistencën e interesit të tij të ligjshëm për të ngritur padi. Referuar përbajtjes së neneve 2 dhe 32 të Kodit të Procedurës Civile, personal fizikë dhe/ose juridikë, në ngrijen e padisë, ndër kushtet e tjera të parashikuara në po këtë Kod, duhet të gëzojnë legitimitet aktiv dhe pasiv. E thënë ndryshe, ato për të parashtruar kërkimet, prapësimet dhe pretendimet e tyre para gjykates, është e domosdoshme që të jenë titullarë të një interesit të ligjshëm dhe kërkimin ta kundër drejtojnë ndaj personit/personave mbi të cilët rëndon detyrimi juridik përkatës.

Në rastin konkret paditësi shoqata "E Invalidëve Paraplegjike dhe Tetraplegjike të Shqipërisë" ka legitimitet aktiv. Ajo është një organizate joftimprurëse, e regjistruar me vendimin nr. 294, date 24.06.2002 të Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe qëllimi dhe objekti i veprimittarisë se saj është: "Sigurimi i një statusi të përshtatshëm të invalidit që ti përgjigjet gjendjes se rende dhe problematikës që kane invalidët paralegjike dhe tetraplegjike si dhe nivelit ekonomik që do të ketë shoqëria ne etapa të caktuara, sigurim të një shërbimi

mjekësor të përshtatshëm profilaktik dhe rehabilitues ne klinika të veçanta si dhe klinikat e specializuara ekzistuese, sigurimin e një trajtimi qytetare me prioritet dhe lehtësimet e mundshme që u duhen bere kësaj kategorie invalidësh ne fushat shkollim, punësim, strehim, lëvizje urbane e interurbane, llixha, mjete lëvizëse për shtëpi e jashtë saj, mjete komunikimi etj.“, fakt i provuar nga të dhënrat e dokumentacionit të paraqitur si provë në gjykim konkretisht akt themelimi, statut, vendim regjistrimi si dhe vërtetimi, datë 01.07.2023, lëshuar nga Zyra e Regjistratit të OJF-ve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pala paditëse pretendon se pavarësisht parashikimeve ligjore që përcaktojnë statusin e invalidëve para dhe tetraplegjikë, përfshirjen dhe aksesueshmérinë e personave me aftësi të kufizuar, ku bëjnë pjesë dhe këta persona (ligji nr. 8626, date 22.06.2000 "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" dhe ligji nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmérinë e personave me aftësi të kufizuar"), akteve administrative vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 478 datë 17.6.2020 "Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Tiranë, të një sipërsaqeje trualli funksional dhe të disa objekteve, brenda territorit të pronës nr.99, me emërim "ish-Reparti Ushtarak nr.5011/45", me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "për miratimin e listës se inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar"; Vendimit të Këshillit Bashkiak Bashkia Tiranë nr. 176, datë 21.12.2020 "Për miratimin e dhënies ne përdorim pa kundershpërbirim, të pronës nr. 99, me emërimin Reparti Ushtarak nr. 5011/45", me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, Shoqatës së Invalidëve Para&Tetraplegjikë" si dhe veprimeve juridike kontratës së huapërdorjs nr. 4389/1 prot, datë 16.02.2021, lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë, në cilësinë e Huadhënësit dhe Shoqatës së Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë, në cilësinë e huamarrësit, si dhe marrëveshjes së bashkëpunimit nr. 12408/1 prot, datë 23.03.2021, lidhur ndërmjet palës paditëse Shoqatës së Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë dhe palës së paditur Bashkia Tiranë, pala e paditur nuk ka përbushur detyrimet për rehabilitimin e tretimit, spostimin e rrjeteve inxhinierike, rehabilitimin e pronës së dhënë në huapërdorje dhe bëren e saj të aksesueshme, duke bërë që shoqata të mos mund të marrë në dorëzim efektivisht pronën dhe ta përdorë atë në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj.

Ndërkohë pala e paditur Bashkia Tiranë ka legjitimitet pasiv, pasi pretendohet se ajo nuk ka përbushur detyrimet sipas parashikimeve ligjore, akteve administrative dhe veprimeve juridike sipërcituar, që përcaktojnë detyrimin e saj për përbushjen e tyre.

Këshilli Bashkiak i Bashkisë Tiranë legjitimohet të thirret ne cilësinë e personit të tretë në gjykim pasi, në bazë të aktit, vendimit nr. 176, date 21.12.2020 "Për miratimin e dhënies ne përdorim pa kundershpërbirim, të pronës nr. 99, me emërimin Reparti Ushtarak nr. 5011/45", me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, Shoqatës së Invalidëve Para&Tetraplegjikë" ai ka vendosur të miratojë dhënien në përdorim, pa kundërshpërbirim, për një periudhë 10-vjeçare, të pronës me nr. 99, me emërim "Reparti ushtarak nr. 5011/45", me sipërsaqe trualli Str. 3300m² dhe sipërsaqe ndërtimi Snd. 466,2 m², me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë (sipas hartës treguese të Regjistrimit), Shoqatës se Invalidëve Para & Tetraplegjike të Shqipërisë, duke ngarkuar Kryctarin e Bashkisë apo personin e autorizuar prej tij për nënshkrimin e kontratës se huapërdorjes midis Bashkisë Tiranë dhe Shoqatës së Invalidëve Para & Tetraplegjikë.

Së dyti, për sa i përket zgjidhjes në themel të çështjes.

Neni 420 i Kodit Civil" Lindja e detyrimeve" parashikon: "Detyrimet lindin nga kontratat ose nga ligji".

Neni 14 i ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", parashikon: "Shteti merr përsipër të vëré në dispozicion dhe të japë falas mijedise për zhvillimin e veprimtarisë së shoqatës të invalidëve paraplegjike dhe tetraplegjike".

Neni 2 i ligjit nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesucshmérinë e personave me aftësi të kufizuar" "Qëllimi" parashikon: "Ky ligj ka për qëllim:"

- a) të garantojë nxijen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes;
- b) të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmérisë për të zgjedhur, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri".

Neni 3/1, 3,6,9,10, 11 i ligjit nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmérinë e personave me aftësi të kufizuar" "Përkufizime" parashikon: "Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1. "Aksesueshmëri" është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve,

3. "Pengesat" nënkupton: a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore; b) pengesat njedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtimë ndijore, veçanërisht ata me dëmtimë në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuara ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t'u lexuar dhe për t'u kuptuar; c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike; ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.

6. "Mohim i përshtatjes së arsyeshme" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur mohohet ose kundërshtohet kryerja e rregullimeve ose ndryshimeve të domosdoshme dhe të përshtatshme që janë të nevojshme në një rast të veçantë, pa vendlorisur një barrë të tepruar, me qëllim garantimin që personat me aftësi të kufizuara të mund të gjëzojnë dhe të ushtronin, në kushte të barabarta me të tjerët, të drejtat dhe liritet themelore të njeriut.

"Organizatë për personat me aftësi të kufizuara" është qdo organizatë joftimprurëse, që ofron shërbime për personat me aftësi të kufizuara dhe/ose kryen aktivitet në mbrojtje të interesave të këtyre personave e të familjeve të tyre.

9. "Persona me aftësi të kufizuara" janë individët që kanë dëmtimë afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtimë të cilat, në bushkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato njedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

10. "Përfshirje" është pjesëmarrja efikase dhe e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës, nëpërmjet heqjes së pengesave sociale njedisore, infrastrukturorë dhe institucionale, të cilat shkaktojnë përjashtimin, izolimin ose veçimin e tyre dhe kufizojnë mundësitë e barabarta për këta persona.

11. "Përshtatje e arsyeshme" është modifikimi dhe rregullimet e nevojshme e të përshtatshme, atëherë kur është e nevojshme, pa vendlorisur barrë të tepruar, për t'u garantuar personave me aftësi të kufizuara gjëzinin ose ushtrimin, uë kushte të barabarta me të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut".

Nga të dhënat e akteve në dosje rezulton se pasuria objekt gjyktimi me nr.99, me emërtim "ish-Reparti Ushtarak nr.5011/45", me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, ka qenë pasuri e pahuajtshme shtetërore, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes.

Me vendimin Nr. 478, datë 17.6.2020 "Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Tiranë, të një sipërsaqeje trualli funksional dhe të disa objekteve, brenda territorit të pronës nr.99, me emërtim "ish-Reparti Ushtarak nr.5011/45", me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "për miratimin e listës se inventarit të pronave të pahuajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar" Këshilli i Ministrave ka vendosur:" 1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Tiranë, të një sipërsaqeje trualli funksional dhe të disa objekteve, me sipërsaqe të përgjithshme prej 3 300 (tre mijë e treqind) m², nga trualli funksional i pronës nr.99, me emërtim "Ish-reparti ushtarak nr.5011/45", vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Në listën e inventarit të pronave të pahuajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të pahuajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

B) Higen trualli funksional dhe objektet, sipas planrilevimit, me sipërsaqe të përgjithshme prej 3 300 (tre mijë e treqind) m², nga trualli funksional i pronës nr.99, me emërtim "Ish-reparti ushtarak nr.5011/45", me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë.

b) Përmasat e pronës nr.99, me emërtim "Ish-reparti ushtarak nr.5011/45", me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin standard të inventarizimit dhe në planrilevimin që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

3. Për sigurinë dhe ruajtjen e pronës, para fillimit të punimeve, Bashkia Tiranë të ndërtojë rrethimin në kufijtë e rinj të pronës dhe qdo element që lidhet me rrethimin, duke i kthyer në gjendjen e tyre të mëparshme, të kryejë spostimin e rrjeteve inxhinierike që prek gjurmë e sipërsaqes së pronës e cila i kalon në pronësi, sipas parametrave e kushteve teknike dhe për këtë të hartoher aktmarrëveshje, ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Mbrojtjes, të përfaqësuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Komanda Mbështetëse.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastritës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

Për zbatimin e këtij vendimi, Ministri i Mbrojtjes ka nxjerë urdhrin nr. 811, datë 13.07.2020 " Për zbatimin e vendimit Nr. 478 datë 17.6.2020 të Këshillit të Ministrave "Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Tiranë, të një sipërsaqeje trualli funksional dhe të disa objekteve, brenda territorit të pronës nr.99, me emërtim "ish-Reparti Ushtarak nr.5011/45", me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "për miratimin e listës se inventarit të pronave të pahuajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar" në bazë të të cilit janë përcaktuari masat konkrete dhe strukturat përkatose për zbatimin e tij.

Në vijim, mes Komandës Mbështetëse (Repartit Ushtarak nr. 4001) dhe Bashkisë Tiranë është lidhur dhc një akt marrëveshje bashkëpunimi nr. 5761 prot, datë 26.10.2020, e cila sipas nenit 1 të saj, kishte për objekt: "I.I Dorëzimi dhe marrja në dorëzim e një sipërsaqeje trualli funksional dhe disa objekteve me sipërsaqe të përgjithshme 3 300 (Tremijë e treqind) m², nga trualli i përgjithshëm funksional i pronës me nr. 99, me emërtimin "Ish Reparti Ushtarak nr. 5011/45", me vendndodhje ne Surrel Farke, Tirane, nga Komanda Mbështetëse të Bashkia Tiranë.

1. 2. Ndërtimi i rrëthimit të plotë të pronës dhe çdo element që lidhet me rrëthimin dhe spostimin e njeteve inxhinierike që prek gjurma e sipërfaqes se pronës, e cila kalon në pronësi të Bashkisë Tiranë, sipas parametrave e kushteve teknike, duke kthyer në gjendjen e tyre të mëparshme.”

Në nenin 2 të kësaj akt marrëveshje përcaktohet: “*Të drejtat dhe detyrimet e palëve”*

2.3 Bashkia Tiranë përparrë fillimit të punimeve ne pronën e marre ne pronësi, me gellim dhe sigurinë e pronës, me shpenzimet dhe personelin e vete do të realizojë:

-Rrëthimin e ploje, ne kufijtë e rinj të e pronës dhe do element që lidhet rrëthimin, duke i kthyer ne gjendjen e mëparshme

-Spostimin e rrjeteve inxhinierike që prek gjurma e sipërfaqes se pronës e cila i kalon në pronësi sipas parametrave e kushteve teknike”.

2.4 Komanda Mbështetëse, nëpërmjet përfaqësuesi i saj ka i drejte të mbikëqyrë cilësinë e kryerjes se punimeve të përcaktuara në pikën 2.3, të marrëveshjeje. Ne rast se këto të fundit, nuk janë kryer sipas parametrave, Komanda Mbështetëse ka të drejtën e reklamimit të tyre pranë Bashkisë Tiranë

2.5 Ne përfundim të punimeve, palët do mbajnë një procesverbal, mbi kryerjen e punimeve sipas akt marrëveshjes.

2.6 Komanda Mbështetëse, ka të drejte mos lejoje fillimin e kryerjes e punimeve nga Bashkia Tiranë, pa realizuar prej saj detyrimet e përcaktuara në pikën 2.3 të kësaj marrëveshje”.

Gjithashtu, në nenin 5 të kësaj akt marrëveshje përcaktohet se: ”*Kohëzgjatja e marrëveshjes” Marrëveshje hyn në fuqi, me nënshkrimin nga të dyja palët dhe e shtrin efektin deri në dorëzimin e pronës, përfundimin e punimeve për rrëthimin e ploje në kufijtë e rinj, si dhe spostimin e njeteve inxhinierike, që prek gjurma e sipërfaqes së pronës, e cila i kalon ne pronësi sipas parametrave e kushteve teknike, nga Bashkia Tiranë”.*

Titullarët e institucioneve Kryetari i Bashkisë Tiranë dhe Komandanti i Komandës Mbështetëse kanë ngritur grupet e punës për marrjen në dorëzim të pronës.

Në vijim, në bazë të akt dorëzimit nr. 5808 regj. 28.10.2020 ”Për dorëzimin nga Reparti Ushtarak nr.4001 dhe marrjen në dorëzim dhe kalim në pronësi nga Bashkia Tiranë, të një sipërfaqeje trualli funksional dhe të disa objekteve, brenda territorit të pronës nr.99, me emërtimin ”Ish Reparti Ushtarak nr. 5011/45”, me vendndodhje në Surrel, Farke, Tiranë” grupet e punës të ngritur me urdhër të Komandantit të Repartit ushtarak 4001 (Komanda Mbështetëse) dhe Kryetarit të Bashkisë kanë bërë dorëzimin nga Repartit Ushtarak 4001 (Komanda Mbështetëse) Tiranë dhe marrjen në dorëzim dhe kalimin në pronësi te Bashkisë Tiranë, të një sipërfaqeje nga trualli funksional dhe të disa objekte, të pronës nr. 99, me emërtimin ”Ish reparti ushtarak nr. 5011/45”, me sipërfaqe të përgjithshme sipas plan rilevimit të hartuar nga IGJIU 3300 (tremijë e treqind) m^2 , nga e cila 466. 2 m^2 sipërfaqe nën objekt, përkatesisht objekti nr. 3=303.9 m^2 , objekti nr. 4=133.7 m^2 dhe objekti nr. 12=28.6 m^2 .

Vlen të thksohet se, pavarësisht përcaktimeve në pikën 3 të VKM Nr. 478, datë 17.6.2020 dhe neneve 2 dhe 5 të akt marrëveshjes së lidhur mes Komandës Mbështetëse dhe Bashkisë Tiranë, marrja në dorëzim e pronës nga Bashkia Tiranë është bërë pa u përbushur nga kjo e fundit detyrimet për rrëthimin e ploje, ne kufijtë e rinj të e pronës dhe çdo element që lidhet rrëthimin, duke i kthyer ne gjendjen e mëparshme si dhe spostimin e njeteve inxhinierike që prek gjurma e sipërfaqes se pronës.

Me Vendimin nr. 176, datë 21.12.2020 ”Për miratimin e dhënes ne përdorim pa kundershpërlim, të pronës nr. 99, me emërtimin Reparti Ushtarak nr. 5011/45”, me vendndodhje në Surrel, farkë, tiranë, Shoqatës së Invalidëve Para&Tetraplegjikë” _Këshilli

Bashkiak i Bashkisë Tiranë ka vodosur: "1. Të miratojë dhënien në përdorim pa kundërshpërblim për një periudhë 10-vjeçare, të pronës me nr. 99, me emërtim "Reparti ushtarak nr. 5011/45", me sipërfaqe trualli Str. 3300m² dhe sipërfaqe ndërtimi Snd. 466,2 m², me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë (sipas hartës treguese të Regjistrimit), Shoqatës se Invalidëve Para & Tetraplegjike të Shqipërisë 2. Ndalohet dhënia në përdorim të tretëve dhe ndryshimi i destinacionit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Ngarkohet kryetari i Bashkisë apo personi i autorizuar prej tij për nënshkrimin e kontratës se huapërdorjes midis Bashkisë Tiranë dhe Shoqatës së Invalidëve Para & Tetraplegjike.

4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 39/2015, "Për vetëgoverisjen vendore", të ndryshuar".

Në vijim, mes Bashkisë Tiranë, në cilësinë e Huadhënësit dhe Shoqatës së Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë, në cilësinë e huamarrësit, është lidhur kontrata e huapërdorjes nr. 4389/1 prot, datë 16.02.2021, ku ne nenin 1 të saj, palët kanë përcaktuar objektin, e konkretisht: "Objekti i kësaj kontrate është dhënia në përdorim nga huadhënësi e truallit, me sipërfaqe 3300 m, ne Tirane, Lanabregas, pa kundërshpërblim për nevoja të huamarrësit", : ndërsa në nenin 2 qëllimin e saj, e konkretisht: "Qëllimi i kësaj kontrate është vënia në dispozicion nga Bashkia Tiranë e truallit me sipërfaqe 3300 m Tirane, Lanabregas, për zhvillimin e veprimtarisë se "Shoqatës se Invalidëve Para dhe Tetraplegjike".

Pra, ndryshe nga sa përcaktohet e vendimin e Këshillit Bashkiak, pala e paditur i ka dhënë palës paditëse në huapërdorje vetëm truallin dhe jo objektet.

Po kështu, ndërmjet palës paditëse Shoqatës së Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë dhe palës së paditur Bashkia Tiranë është lidhur marrëveshja e bashkëpunimit me nr. 12408/1 prot, datë 23.03.2021, e cila, sipas parashikimeve të nenit 1 të saj, kishte për objekt: "Përcaktimi i mënyrave të bashkëpunimit mes palëve për ofrim të shërbimeve cilësore ndaj qytetarëve që i përkasin grupeve në nevojë. Gjithashtu të përcaktoje mënyrat e bashkëpunimit të efektshëm mes palëve në rastet e adresimit të problematikave për ofrimin e shërbimeve me fokus të veçantë për integrimin e personave me aftësi të kufizuara në komunitet, rrjite të gjithëpërfshirës së personave me aftësi të kufizuara, si edhe aksesueshmérinë e tyre në shërbimet komunitare me qëllim riintegrimin e tyre".

Gjatë gjykimit rezultoi që pala paditëse, i është drejtuar me kërkesa të vazhdueshme me shkrim palës së paditur ku i ka kërkuar të përmbushe detyrimet për rehabilitimin e tretimit, spostimin e rrjetave inxhinierike, rehabilitimin e pronës së dhënë të huapërdorje dhe bërijen e saj të aksesueshme nga persona me aftësi të kufizuara që përdorin kartige me rota. Në gjykim u paraqitën në cilësinë e provës kërkuesat e palës paditëse dhe ndërkohë pala e paditur nuk rezultoi të këtë dalë me një përgjigje konkrete. Në gjykim nga pala e paditur u paraqit si provë shkresa nr. 42392 prot, datë 01.12.2022 e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit pranë Bashkisë Tiranë drejtuar Drejtorisë së Menaxhimit Financiar panë kësaj Bashkie, në të cilën, ndër të tjera, thuhet se: "Pranë Bashkisë Tiranë është depozitar shkresa me nr.SH-3108/1 prot., date 15.02.2022, me anë të së cilës N/kryetarja znj. Anisa Ruseti, me kërkesë të Shoqatës së Invalidëve Para & Tetraplegjik Shqiptare kërkon mundësimin e rrithimit të kufijve të rinj të pronës dhe çdo elementi që lidhet me rrithimin.

Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, me anë të shkresës SH-3108/4 prot., datë 10.05.2022, ka bërë me dije se projekt i kërkuar është bërë pjesë në Programin Buxhetor Afatmesëm 2022- 2024, duke parashikuar ndërtim- montimin e projektit.

Për sa më sipër kërkojmë nga ana juaj informacion në lidhje me masat e marra nga ana e drejtorisë suaj për përfshirjen në Programin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 të projektit të sipërcituar".

Në përgjigje të kësaj shkresë, Drejtoria e Menaxhimit Financiar pranë Bashkisë Tiranë, me shkresën nr. 42392/1 prot, datë 06.12.2022, me lende "Kthim përgjigje" informon Drejtorinë e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit pranë Bashkisë Tiranë se: "Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, Drejtorisë së Buxhetit, është depozituar shkresa me Nr. Prot 42392, datë 01.12.2022 nga Drejtoria e Ankimimeve me lëndë: "Kërkesë për informacion", për të cilën ju bëjmë me dije si më poshtë:

Projekti i investimit "Rrethimi i pronës "Ish Reparti Ushtarak nr. 5011/45", Surrel" me kosto të plotë 2,893,797 lekë është pjesë e PBA 2022-2024 referuar kérkesës buxhetore nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike".

Po kështu, pala e paditur paraqiti në cilësinë e provës në gjykim dhe shkresën nr. 43516/1 prot, datë 16.12.2022, me lende "Kalim për kompetence" të Drejtorisë së Planifikimit të Punëve Publike pranë Bashkisë Tiranë, drejtuar Drejtorinë e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit pranë Bashkisë Tiranë në bazë të të cilës informon se: "Referuar shkresës suaj me nr. 43516 prot., datë 09.12.2022, ardhur pranë Drejtorisë së Planifikimit të Punëve Publike, me lëndë "Kërkesë për informacion" lidhur me objektin "Ish Reparti Ushtarak nr. 501 I/45" me vendndodhje në Surrel, i cili ka kaluar në pronësi Shoqatës së Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë, nëse është zbatuar projekti për rrethimin e kufijve të rinj të pronës dhe qdo elementi të lidhur me rrethimin, ju informojmë se:

Në vijim të korrespondencës së mëparshme me anë të shkresës nr. Sh-3108/5 prot., date 18.11.2022. Drejtoria e Planifikimit të Punëve Publike i ka kerkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit "Detajimin e projekt zbatimit sa me pare dhe dorëzimin e tij për diskutim dhe miratim ne Këshillin Teknik të Drejtorisë së Planifikimit të Punëve Publike, ne mënyrë që të vazhdojmë me procedurat e prokurimit brenda këtij viti buxhetor". Bashkëlidhur shkresa nr. Sh-3108/5 prot., date 18.11.2022"

Bashkëlidhur u paraqit dhe shkresa nr. Sh-3108/5 prot., date 18.11.2022 , me lende "Kërkese për bashkëpunim" e Drejtorisë së Planifikimit të Punëve Publike drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të territorit pranë Bashkisë Tiranë në të cilën thuhet se: "Pranë Drejtorisë se Përgjithshme të Punëve Publike janë depozituar shkresat nje nr. Sh 3108/1 prot. date 15.02.02022 dhe nr. 30651 prot., date 01.09.2022, me anë të së cilave është kerkuar nga Shoqata e Invalidëve Para- Tetraplegjike të Shqipërisë SHIPT planifikimi i fondit i ndërtimit, në Programin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, për projektin e rrethimit të ish repartit ushtarak që do të përdoret nga shoqata, sipas vendimit nr. 176, date 21.12.2020, të Këshillit Bashkiak Tiranë.

Drejtoria e Planifikimit të Punëve Publike e ka bere pjese të buxhetit afatmesëm 2022-2024 vlerën e ndërtim-montimit për rrethimin e ish repartit ushtarak, por nuk mund të vijoje me procedurat e mëtejshme pa pasur projektin, i cili është hartuar me pare nga Drejtoria juaj.

Për sa me sipër, kërkojmë nga drejtoria juaj detajimin e projekt-zbatimit sa me pare dhe dorëzimin e tij për diskutim dhe miratim ne Këshillin Teknik të Drejtorisë se Përgjithshme të Punëve Publike, në mënyrë që të vazhdojmë me procedurat e prokurimit brenda këtij viti buxhetor"

Pra, në analizë të kësaj korrespondencë shkresore mes strukturave të brendshme të Bashkisë Tiranë provohet se është përcaktuar një kosto financiare vetëm për rrethimin e pronës, e cila është bere pjese e PBA 022-2024, ndërkohë që projektimi nuk është përfunduar ende nga strukturat përkatëse. Në mungese të projektit nuk mund të përcaktohet nëse ai përfshin dhe qdo element që lidhet me rrethimin dhe spostimin e rrjeteve inxhinierike sipas përcaktimeve ne aktet administrative VKM dhe VKB si dhe veprimet juridike (kontrate huapërdorje, marrëveshje bashkëpunimi të lidhur mes palëve. Në këto kushte gjykata çmon se pala paditëse është ne kushtet e mosveprimit për përbushjen ne kohe dhe efektive të këtyre detyrimeve, rrijetet e gjenden të bazuara kërkimet objekt padie të paditësit për ta detyruar gjyqësisht palën e paditur të ndërtojë rrethimin e kufijve të rinj të pronës nr. 99

"Repart Ushtarak nr. 5011/45, me vendndodhje në Surrel, Farke, Tiranë dhe çdo element që lidhet me rrëthimin, duke i kthyer ato në gjendjen e mëparshme (te rehabilituar), si dhe të kryeje spostimin e rrejteve inxhinierike që prek gjurma e sipërsfaqes se pronës (rrjet rrugor, kanalizime uji të pijshëm dhe ujera të shkarkimit, lidhje me trjetin e energjisë elektrike, etj.).

Po kështu, gjatë gjykimit u provua se pasuria që i ka kaluar palës paditëse ne huapërdorje sipas vendimit nr. 176, datë 21.12.2020 "Për miratimin e dhënes ne përdorim pa kundershpërblim, të pronës nr. 99, me emërimin Reparti Ushtarak nr. 5011/45", me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, Shoqatës së Invalidëve Para&Tetraplegjik" të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Tiranë ndodhet ne një terren të thyer, pa rrugë të përshtatshme lidhëse me rrugën kryesore për tu përdorar nga personat paraplegjike dhe tetraplegjike, që përdorin karrige me rrrota. Ne zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" dhe ligjit nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshunërinë e personave me aftësi të kufizuar" pala e paditur, si organ shtetëror vendor, ka detyrimin të marrë masa për të garantuar përfshirjen dhe aksesueshmërinë, për të hequr pengesat për personat me aftësi të kufizuar, që aderojnë në shoqatën paditëse, me qëllim mundësimin e vajtjes se tyre ne selinë e shoqatës, duke garantuar nc këtë mënyrë një nder të drejtat e tyre themelore që është ajo e organizmit. Për rrjedhoje, gjykata e gjen të bazuar dhe kërkimin tjetër objekt padie për detyrimin e të paditurit Bashkia Tiranë të krijoje të gjitha kushtet e përshtatshme për aksesueshmërinë, duke ndërtuar rrugën lidhëse me rrugën kryesore automobilistike dhe të eliminoje të gjitha pengesat infrastrukturore dhe mjedisore në pronën me emërimin "Repart Ushtarak nr. 5011/45, me vendndodhje ne Surrel, Farke, Tiranë, për personal paraplegjike dhe tetraplegjike (qe përdorin karrige me rrrota).

Po kështu nga aktet e dosjes provohet se mes Bashkisë Tiranë në cilësinë e Huadhenësit dhe Shoqatës së Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë, në cilësinë e Huamarrësit, është lidhur kontrata e huapërdorjes nr. 4389/1 prot, datë 16.02.2021, ku ne nenin 1 të saj, palët kanë përcaktuar objektin e konkretisht: "*Objekti i kësaj kontrate është dhënia në përdorim nga huadhënësi e truallit, me sipërsaqe 3300 m, ne Tirane, Lanabregas, pa kundërshpërblim për nevoja të huamarrësit*", : ndërsa në nenin 2 qëllimin e saj, e konkretisht: "*Qëllimi i kësaj kontrate është vënia në dispozicion nga Bashkia Tiranë e truallit me sipërsaqe 3300 m Tirane, Lanabregas, për zhvillimin e veprimitarisë se "Shoqatës se Invalidëve Para dhe Tetraplegjike".*".

Pra, ndryshe nga sa përcaktohet në vendimin e Këshillit Bashkiak, pala e paditur i ka dhënë palës paditëse në huapërdorje vetëm truallin dhe jo objektet.

Po kështu, no akt marrëveshjen e bashkëpunimit, të lidhur ndërmjet palës paditëse Shoqatës së Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë dhe palës së paditur Bashkia Tiranë, nenin 4 të saj, ndër të tjera përcaktohet se : " *4.2 Bashkia Tiranë merr përsipër...Dhënen në përdorim pa kundërshpërblim për një periudhë 10-vjeçare, të pronës me nr. 99, me emërim "Reparti ushtarak nr. 5011/45", me sipërsaqe trualli Str.- 3300m dhe sipërsaqe ndërtimi Sud. 466,2 m², me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë (sipas hartës treguese të Registrimit), Shoqatës së Invalidëve Para & Tetraplegjikë të Shqipërisë, miratuar me VKB nr. 176, date 21.12.2020. Gjithashtu referuar vendimit të sipërcituar është lidhur kontratë huapërdorje me nr. prot. 4389/2, datë 16.02.2021 midis Bashkisë Tiranë dhe Shoqatës së Invalidëve Para dhe Tetraplegjik të Shqipërisë*".

Pra, dhe ne këtë rast jemi ne kushtet e mosveprimit të palës së paditur për të zbatuar vendimin e Këshillit Bashkiak për kalimin ne përdorim pa kundershpërblim dhe të objekteve. Në këto kushte, gjendet i bazuar kërkimi i palës paditëse për ta detyruar palen e paditur t'i japë paditësit në përdorim, pa kundërshpërblim, me huapërdorje, pronën nr. 99, Reparti

Ushtarak nr. 5011/45, me vendndodhje ne Surrel, Farke, Tirane, në mënyrë të përshtatshme për të përbushur qëllimin e zhvillimit të veprimitarës së paditësit.

Në sintezë të gjithë sa më sipër u citua, gjykata çmon se kërkimet për të detyuar palën e paditur të përbushë detyrimet cituar ne objektin e padisë gjenden të bazuara. Kërkësë padia për këtë pjesë është e bazuar dhe duhet pranuar.

Së treti, për sa i përket kërkimit për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, gjykata çmon se ky përbën një kërkim të bazuar. Neni 317 të K.Pr.Civile parashikon: “*Vendimi i gjykatës mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm, kur është vendosur: a) detyrimi për ushqim; b) për shpërbllimin nga puna; c) për rivendosjen në posedimin e banesës bashkëshortore. Vendimi mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm edhe kur nga vonesa e ekzekutimit, paditësi mund të pësojë dëme të rëndësishme, gë nuk mund të vihen në vend, ose kur ekzekutimi i vendimit do të bëhej i pamundur, ose do të vështirësohet së tepërm*. Në këtë rast gjykata mund të kërkojë që paditësi të japë një garanci”. Në rastin konkret, në analize të provave të paraqitura, gjykata çmon se paditësit i shkaktohet një dem i rende nga vonesa ne ekzekutimin e vendimit për detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë të përbushë detyrimet sipas citimeve nc objektin e padisë. Vonesa që përezikon shkaktimin e demit lidhet me këto rrithana :

-Pavarësisht se me vendim të Këshillit Bashkiak është përcaktuar dhënia nc huapërdorje e pronës për një periudhe 10 vjeçare, me kontraten e huapërdorje çshtë dhënë vetëm truallë dhe ende nuk ka një veprim juridik për kalimin e objekteve. Pra, kanë kaluar mbi dy vite pa u ndërmarrë asnjë veprim.

-Sipas shkresave, paraqitur si prove ne gjykim, pala e paditur ka përcaktuar buxhet vetëm për të mbuluar projektin për rrithimin e pronës, ndërkohë që VKM dhe VKB përcaktojnë detyrime për palën e paditur për të mbuluar dhe çdo element që lidhet me rrithimin (duke i kthyer ato në gjendjen e mëparshme, të rehabilituar), si dhe të kryeje spostimin e rrjeteve inxhinierike. Nga koha kur ka dalë vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 176, datë 21.12.2020 në bazë të të cilët është disponuar që prona (truall +objekte) të kaloje ne përdorim të palës paditëse, ka kaluar një afat i gjatë dhe nuk rezulton të jene marre masa të plota dhe efektive për përbushjen e këtyre detyrimeve.

-Pala paditëse është një organizate që përfaqëson intercsat e një kategorie individësh, që për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore, shteti ka detyrimin ligjor që tu ofroje ndihme ne mënyrë të veçantë, ku ndër të tjera është dhe ajo për vënien në dispozicion të njediseve për zhvillimin e veprimitarës së tyre dhe marrjen e masave për të garantuar aksesueshmérinë në këto njedise, duke hequr pengesat mjedisore dhe infrastrukturore.

-Paraqitura e një ankimi ndaj këtij vendimi dhe koha e gjatë që do morrtë çështja për tu shqyrta nga Gjykata Administrative e Apelit, kjo për shkak të ngarkesës së madhe (numrit të madh të dosjeve në pritje për shqyrtim, fakt tashmë i njohur), do t'i shkaktonte dem të rënde palës paditëse, deri dhe të parikuperueshëm dhe që lidhet me kalimin e afatit të huapërdorjes, pa u vënë prona në përdorim.

Bazuar në parashikimet e nenit 317 dhe 510/a të K.Pr.Civile, neneve 41 dhe 65 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykitin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, ky vendim, përbën titull dhe duhet të ekzekutohet nga përbushja gjyqësor .

Së katërti, për sa u përket shpenzimeve gjyqësore dhe atyre për vënien ne ekzekutim të vendimit, bazuar ne nenin 106 të K.Pr.Civile, ato duhet t'u ngarkohen palës së paditur. Këto shpenzime përbëhen nga shpenzimet e verifikuara, të renditura në fund të këtij vendimi.

Së pesti, lidhur me të drejtën e ankimit të këtij vendimi, për pjesën që shprehet për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, bazuar ne nenin 318 të K.Pr.Civile, Icjohet ankim i

veçantë në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e njostimit të vendimit të arsyetuar. Për pjesën tjeter lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e njostimit të vendimit të arsyetuar.

Në përfundim, duke pasur parasysh gjithë sa më sipër u citua, gjykata çmon se kërkesa padia e paditësit çshlë e bazuar ne ligj dhe prova dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 40, 41 të ligjit nr. 49/ 2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar dhe nenct 310, 317 dhe 318 të K.Pr.Civile

VENDOSA:

- Pranimin e kërkesa padisë së paditësit Shoqata Humanitare e Invalideve Paraplegjike dhe Tetraplegjike të Shqipërisë.
- Detyrimin e të paditurit Bashkia Tiranë të ndërtojë rrëthimin e kufijve të rinj të pronës nr. 99 "Repart Ushtarak nr. 5011/45, me vendndodhje në Surrel, Farke, Tiranë dhe çdo element që lidhet me rrëthimin, duke i kthyer ato në gjendjen e mëparshme (te rehabilituar), sipas pikës 3 të VKM nr. 478, datë 17.6.2020 "Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Tiranë, të një sipërsfaqjeje trualli funksional dhe të disa objekteve, brenda territorit të pronës nr.99. me emërtim "Ish-Reparti Ushtarak nr.5011/45", me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, date 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin c listës se inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi ministrisë së mbrojtjes", të ndryshuar".
- Detyrimin e të paditurit Bashkia Tiranë të kryeje spostimin e rrjetave inxhinierike që prek gjurma e sipërsfaqes se pronës (rrjet rrugor, kanalizime uji të pijshëm dhe ujera të shkarkimit, lidhje me rrjetin e energjisë elektrike, etj.) sipas parametrave e kushteve teknike që mundëson shfrytëzimin efektiv të pronës nga paditësi, sipas pikës 3 të VKM nr. 478, datë 17.6.2020 "Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Tiranë, të një sipërsfaqjeje trualli funksional dhe të disa objekteve, brenda territorit të pronës nr.99. me emërtim "Ish-Reparti Ushtarak nr.5011/45", me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, date 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin c listës se inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi ministrisë së mbrojtjes", të ndryshuar".
- Detyrimin e të paditurit Bashkia Tiranë të krijoje të gjitha kushtet e përshtatshme për aksesueshmerine, duke ndërtuar rrugën lidhëse me rrugën kryesore automobilistike dhe të eliminonte të gjitha pengesat infrastrukturore dhe mjedisore në pronën me emërtimin "Repart Ushtarak nr. 5011/45, me vendndodhje në Surrel, Farke, Tiranë, për personal paraplegjike dhe tetraplegjike, që përdorin karrige me rrota.
- Detyrimin e të paditurit Bashkia Tiranë, t'i japë paditësit ne përdorim, pa kundërshtpërbirim, me huapërdorje, pronën nr. 99 Repart Ushtarak nr. 5011/45, me vendndodhje në Surrel, Farke, Tiranë, ne mënyrë të përshtatshme për të përbushur qëllimin e zhwillimit të veprimtarisë së paditësit.
- Shpenzimet gjyqësore dhe ato përvienien ne ekzekutim ne ngarkim të palës së paditur.

- Bazuar ne nenin 317 të K.Pr.Civile, vendimi jepet me ekzekutim të përkohshëm, përben titull dhe duhet të ekzekutohet nga përmbarimi gjyqësor
- Kundër këtij vendimi, për pjesën që shprehet për dhënen e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, lejohet ankim i veçantë në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e njostimit të vendimit të arsyetuar. Për pjesën tjeter lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e njostimit të vendimit të arsyetuar.
- Vendimi i arsyetuar t'u komunikohet palëve.
- U shpall, në Tiranë, më 28.02.2023!

SEKRETARE

ERJONA UKPERAJ



GJYQTARE
SELVIE GJOCAJ
28.02.2023